Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	**10.01.2024**	**13.01.2024**	**2024/0010**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.01.2024, OE "EUROPRINT GROUP SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0010, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material te ndryshem zyrtar" me nr. të prokurimit: "214-23-11396-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00 €. Më Nr. 2024/0010 i dt:04.01.2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

--Jeni duke shkelur si primar NENIN 1 te LPP-se sepse ju nuk jeni aspak transparent efikas dhe duke shfrytezuar fondet publike ne menyre e duhur .

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

--Ju jeni duke e shkelur kete NENI sepse ju nuk jeni duke siguruar fondet publike por ju jeni duke i shkatrruar fondet publike duke keqperdorur buxhetin e shtetit keshtu duke e shpallur fitues nje OE i cili eshte me cmim afer 15 mije euro me te larte se kompania jone sepse ky OE eshte i favorizuar dhe i perferuar i juve.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që

diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

--Ndersa gjate pergaditjes e kesaj procedure eshte duke u shkelur ligji I prokurimit si dhe duke bere diskriminim sa i perket vleresimit dhe shperblimit te kontrates nje OE me cmimin me te larte se ne.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

--AK-ja ne kete rast edhe pse ka themeluar komision te vleresimit por i cili komision eshte formuar me tendencen per te na eliminuar neve si kompani e cila kemi qene e pergjegjshme ne tere aspektet dhe me cmimin me te ulet te ofruar , por keshtu nuk kane dashur sepse ne arsyetimin e tyre per eliminim eshte banal sepse terheqjen e mostres na kane bere me tendence vetem e vetem per te na eliminuar , dhe me kete te shpallin fitues oe e tyre te preferuar.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

--AK-ja nuk ka respektur kete nen te LPP-se duke derguar kete aktivitet ne shperblimin e kontrates OE-se me cmimin me te larte te ofruar .

ARGUMENTE/PROVA :

Me daten 04.12.2023 ORA13:00 eshte bere dalje nga depoja per mostrat per tenderin **Furnizim me material të ndryshëm zyrtar** te MPB dhe te gjitha keto jane numruar dhe jane vertetuar nga zyrtari i depose per kontrollin e stokut dhe faturimin ne pergaditjen e mostrave dhe verifikimin e tyre jan tre zyrtar qe kane krye pregaditjen edhe markimin e mostrave dhe te gjithat mostrat jane nda dhe paketue ne dy pako njera per MPB kurse tjera per menagjerin e kontratave me blers i cili e pregadie mallin sipas mostrave te dergura.

Keshtu qe eshte 100% sigurte qe mostrat e kerkura nga dosja e tenderit jane paketue dhe dergue ne tersi artikulli i kontstuar numer 26 ka qene i markuar dhe paketuar ne dy ngjyra per mos te kete keqkuptim per ngjyrat ne rastin e porosis nga autoriteti.

Kurse sa i perket printimit te logos ne mostra nuk ka qene kerkes ne dokumentin e tenderit sepse ne nuk kemi marre kurrfare dizajini nga Autoriteti Kontraktues dhe kerkes qe atije dizajni te printohet ne mostra. Bazuar në përshkrimin e mësipërm dhe dispozitat ligjore te lartcekura te LPP-se dhe Ligjeve tjera ne fuqi konstatojmë se AK- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** eshte duke bërë shkelje dhe vleresim jo te drejte dhe te gabuar te ligjeve te lartcekura duke minimizuar konkurencen duke krijuar monopol ne tregu dhe duke shkeluar parimet e LPP-se qe jane transparenca dhe konkurenca.

Kërkojmë nga OSHP-ja me qe sipas dispozitave ligjore te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, te aprovoj kërkesën për rishqyrtim tonë si të **BAZUAR** dhe të kthejë lëndën prapë në **RI-VLERËSIM si dhe te mirren masa ndaj zyrtareve te prokurimit te cilet me qellim e kane larguar mostren vetem per ten a eliminuar neve si OE dhe te shpallim fitues Operatorin ekonomik te cilet ja kane pergaditur proceduren nga fillimi.**

Bashkanegjitur gjeni edhe dudat doganore per posedim te kimikave si dhe fletedorezimin e mallit dhe flete pranimin e mallit nga punetore I prokurimit ne kompanine tone si dhe fletedorezimin e mallit per MPB

Faleminderit per mirekuptim

Me Respekt.

EUROPRINT GROUP SHPK

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte në ketë Ankese, dëshmitë e bashkangjitura kësaj ankese dhe dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së, që Ankesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të urdhërohet AK– MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME te kthej lenden ne rivleresim dhe njeheresi te I kthej te gjitha mostrat se bashku me mostren qe e kane larguar me qellim dhe te mirren masa ndaj zyres e prokurimit ne baze te nenit 90 te ju revokohet certifikata e prokurimit per shkeljet qe I kane bere

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte-furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të përfunduar me sukses të gjitha së bashku në vlerë jo me pak së 150,000.00euro	**1. Lista e projekteve e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte të përfunduara në lëmin e furiyimeve të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve.**
2.Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, është i obliguar me ofertë të dorëzojnë MOSTËR për artikujt 9,23,24,25,26,29,30,32,33,34,35,37,38,39,40,59,60,61,63,80,109 dhe 131.	**2. Mostrat për artikujt 9,23,24,25,26,29,30,32,33,34,35,37,38,39,40,59,60,61,63,80,109 dhe 131 , duhet të dorëzohen paraprakisht në një paketim të mbyllur me shënimet e kompanisë ofertuese, para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.**
3.Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes Një Menaxheri të projektit a. Duhet të jetë me diplomë univerzitare nga fusha e menaxhmentit. b. Përvojë pune, minimumi 3 vite pas diplomimit. c. CV-në, d. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit	**3. Për Menaxherin e projektit duhet të dëshmoj me a. Diplomë Universitare përkatëse – (kopje e noterizuar). b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje). c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar –(Kopje). d. CV-në; e. Deklaratë nga OE te nënshkruar dhe vulosur.**
4. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes Një (1) Dizajner - Diplomë universitare në Dizajn Grafik.	**4. Për Dizajner duhet të dëshmoj me a. Diplomë Universitare përkatëse – (kopje e noterizuar). b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje). c. CV-në;**
5. Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të dëshmojë së është i certifikuar me Certifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001 2015.	**2. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje e noterizuar) ose linku per verifikim .**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	EUROPRINT GROUP SH.P.K. 810860587	
2.	Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P. 810446072	
3.	G.I.Grafo - Loni SH.P.K. 810499633	

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, për tenderin **"Furnizim me material të ndryshëm zyrtar"**, pas shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesit në tenderët e tyre, duke u bazuar në kriterin për dhënien të kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët), nga tre tenderues ofertues vetem një është i përgjegjëshem komisioni këtë vlersim e mbeshtet dhe në nenin 59.4 të LPP-së dhe i rekomandojnë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, që me këtë kontratë të shpërblehet tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët të tendeuesit,Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P., Gustav Majer Nr.13, 10000, Prishtinë, në vlerë totale të ofertës në shumë prej 119,749.85€.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Sipas Autorizimit Nr. 2024/0010, Me qëllim që shqyrtimi i pretendimeve ankimore të OE ankues të bëhet në mënyrë objektive dhe përpilimi i Raportit të Ekspertizës të jetë i bazuar në fakte dhe argumente , në pajtim me neni 114 të LPP-së, *"Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues",* në cilësinë e Ekspertit Shqyrtues për shqyrtimin e ankesës së OE ankues "EUROPRINT GROUP" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material të ndryshëm zyrtar" me numër të prokurimit 214-23-11396-1-2-1, të iniciuar nga AK – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, kam kërkuar takim në AK-MPB përkatësisht me zyrën e prokurimit për qasje në Mostrat e Tenderit.

Sipas kërkesës nga Eksperti shqyrtues, AK ka prezantuar Mostrat e Tenderit të dorëzuara nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Më poshtë, përgjigjet në pretendimet ankimore, do ti pasqyrojmë me të gjeturat dhe konstatimet nga Eksperti shqyrtues.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **EUROPRINT GROUP SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material të ndryshëm zyrtar", me numër të prokurimit: 214-23-11396-1-2-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 02.11.2023, me datë 20.11.2023 dhe 23.11.2023 ka publikuar B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.
AK me datë 19.12.2023 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ndërsa OE "EUROPRINT GROUP.", kunder vendimit te AK-se, me datë 22.12.2023, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

AK me datë 28.12.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 04.01.2024 OE "EUROPRINT GROUP", ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2024/0010**, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:**

AK-MPBmedatë19.12.2023,përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Lertës standarde, ka njoftuar Operatorët Ekonomik pjesëmarrës për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, njëherit edhe parashtruesi i ankesës OE ankues **"**EUROPRINT GROUP",, është njoftuar për arsyet e eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit.Në vendimin e lartcekur të AK-së janë dhënë dy arsye për eliminimin e OE ankues , ku thuhet se:

"Ju nuk keni ofruar mostrat sipas kerkesave dhe specifikave teknike të AK-së, asnjë nga mostrat per artikujt e kerkuar te ofruar nga OE ankues nuk permbajne mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave te kerkuara nga AK ne Njoftim për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit, dhe gjithashtu per artikullin nr. 26 nuk ka ofruar fare mostër".

Pretendimi ankomor i OE ankues: "Me daten 04.12.2023 ORA13:00 eshte bere dalje nga depoja per mostrat per tenderin Furnizim me material të ndryshëm zyrtar te MPB dhe te gjitha keto jane numruar dhe jane vertetuar nga zyrtari i depose per kontrollin e stokut dhe faturimin ne pergaditjen e mostrave dhe verifikimin e tyre jan tre zyrtar qe kane krye pregaditjen edhe markimin e mostrave dhe te gjithat mostrat jane nda dhe paketue ne dy pako njera per MPB kurse tjera per menagjerin e kontratave me blers i cili e pregadie mallin sipas mostrave te dergura. Keshtu qe eshte 100% sigurte qe mostrat e kerkura nga dosja e tenderit jane paketue dhe dergue ne tersi artikulli i kontstuar numer 26 ka qene i markuar dhe paketuar ne dy ngjyra per mos te kete keqkuptim per ngjyrat ne rastin e porosis nga autoriteti .

Kurse sa i perket printimit te logos ne mostra nuk ka qene kerkes ne dokumentin e tenderit sepse ne nuk kemi marre kurrfare dizajini nga Autoriteti Kontraktues dhe kerkes qe atije dizajni te printohet ne mostra. Bazuar në përshkrimin e mësipërm dhe dispozitat ligjore te lartcekura te LPP-se dhe Ligjeve tjera ne fuqi konstatojmë se AK- MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME eshte duke bërë shkelje dhe vleresim jo te drejte dhe te gabuar te ligjeve te lartcekura duke minimizuar konkurencen duke krijuar monopol ne tregu dhe duke shkeluar parimet e LPP-se qe jane transparenca dhe konkurenca".

<u>Përgjigje Pretendimit ankimor:</u>

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik përkatësisht arsyes së eliminimit nga AK si dhe pretendimit ankimor të OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

Sa i përket arsyes se eliminimit të OE ankues, sipas AK-se "*OE ankuesper artikullin nr. 26 nuk ka ofruar fare mostër",* ndërsa *OE ankues pretendon se "AK* terheqjen e mostres na kane bere me tendence vetem e vetem per te na eliminuar"lidhur me kete pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se:

Sipas Autorizimit Nr. 2024/0010, me qëllim që shqyrtimi i pretendimeve ankimore të OE ankues të bëhet në mënyrë objektive dhe përpilimi i Raportit të Ekspertizës të jetë i bazuar në fakte dhe argumente , në cilësinë e Ekspertit Shqyrtues për shqyrtimin e ankesës së OE ankues "EUROPRINT GROUP" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material të ndryshëm zyrtar" me numër të prokurimit 214-23-11396-1-2-1, të iniciuar nga AK – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, në pajtim me neni 114 të LPP-së, *"Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues",* kam kërkuar takim në AK-MPB përkatësisht me zyrën e prokurimit për qasje në Mostrat e Tenderit.

Sipas kërkesës nga Eksperti shqyrtues, AK-MPB ka prezantuar Mostrat e Tenderit të dorëzuara nga Operatorët Ekonomik respektivisht mostrat e dorëzuara nga OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë prezantimit të mostrave të tenderit të dorezuar nga OE ankues, ndër të tjera, AK ka deklaruar se, "mostra për artikullin nr. 26 mungon", dhe sipas AK-së "mostra për artikullin nr. 26 nuk ka qenë e përfshirë fare në paketimin e dorëzuar nga OE ankues". Gjithashtu, ZPP ka deklaruar se, "në kohen kur janë hapur mostrat e tenderit, edhe unë si ZPP kam qenë i pranishem bashkë me komisionin në përbërje prej tre anëtareve, dhe gjatë vleresimit të

mostrave, mostra për artikullin nr. 26 ka munguar, dhe nuk qënderon pretendimi i OE ankues për terheqjen e mostres nga AK për artikullin nr. 26".

AK ka deklaruar se, "arsyet e eliminimit të OE ankues kanë qenë për shkak se asnjë nga mostrat për artikujt e kërkuar të ofruar nga OE ankues nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit, si dhe gjatë vleresimit të tenderit mostra për artikullin nr. 26 ka munguar dhe nuk ka qenë e përfshirë fare në paketimin e dorëzuar nga OE ankues".

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e lartë cekura, sa i përket këtij pretendimi ankimor të OE ankues për *"terheqjen e mostres nga AK me tendence vetem e vetem per te na eliminuar"*, konsideron se, konstatimi dhe argumentimi i këtij pretendimi ankimor është përtej mundësive dhe kapaciteteve të Ekspertit shqyrtues, megjithatë, kurdo që OE ka dyshime të bazuara lidhur me këtë çështje, mund ti drejtohet organeve kompetente.

<u>Përgjigje Pretendimit ankimor:</u>

Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit të OE ankues, sipas AK-së "*asnjë nga mostrat për artikujt e kërkuar të ofruar nga OE ankues nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit*", ndërsa OE ankues pretendon se "*printimit te logos ne mostra nuk ka qene kerkes ne dokumentin e tenderit sepse ne nuk kemi marre kurrfare dizajini nga Autoriteti Kontraktues*".

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik përkatësisht arsyes së eliminimit nga AK si dhe pretendimit ankimor të OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron se, Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

<u>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:</u>

2.Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, është i obliguar me ofertë të dorëzojnë MOSTËR për artikujt 9,23,24,25,26,29,30,32,33,34,35,37,38,39,40,59,60,6 1,63,80,109 dhe 131.

<u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u>

2. Mostrat për artikujt 9,23,24,25,26,29,30,32,33,34,35,37,38,39,40,59,6 0,61,63,80,109 dhe 131 , duhet të dorëzohen paraprakisht në një paketim të mbyllur me shënimet e kompanisë ofertuese, para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sqaron se :

Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, si dhe bazuar në Mostrat e Tenderit të dorëzuara nga OE ankues të cilat janë prezantuar nga AK, për artikujt: **nr. 30, 32, 37, 38, 39, dhe 40** , nuk janë dorëzuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit përkatësisht specifikacionit tekinik të përcaktuar nga AK.

30	Laps kimik me mbishkrim MPB kualitativ ekuivalent me Schenider	copë	1000
32	Punim artizanal ne kornize xhami brenda kornizes prej gjami te ket gur dekorativ me forma te ndryshme me mundesi te heqjes dhe vendosjes ne murëkorniza te kete graviruar logon ne nje pllake metalike color me dinesion 5x10 cm, dimensioni i kutise 16x21cm dhe trashesi trashesi 5 cm	copë	10
37	Laps kimik 1/2 me kuti te mbeshtjellur nga lekura artificiale mbishkrim MPB kualitativ dhe me paketim	set	105
38	Laps kimik 1/1 me kuti te mbeshtjellur nga lekura artificiale mbishkrim MPB kualitativ dhe me paketim	set	5
39	Laps kimik 1/1 te drurit me kuti druri me mbishkrim MPB kualitativ me paketim	set	5
40	Laps kimik 1/2 te drurit me kuti druri me mbishkrim MPB kualitativ me paketim	set	5

Eksperti shqyrtues konsideron se, bazuar në mostrat e prezantuara nga AK, të cilat janë dorëzuar nga OE ankues për artikujt e lartë cekur, nuk janë dorëzuar sips kërkesës në dosjen e tenderit sepse nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht **pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.**

Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës faktet dhe dëshmitë, si dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit kosideroj se, AK ka bërë vleresimin e tenderit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së.

Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP, përcakton :

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **EUROPRINT GROUP SH.P.K.**

ismail rushiti